

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tronditëse në Itali/ Shpërbëhet rrjeti ndërkombëtar i pedofilisë, 10 të arrestuar në Romë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/tronditese-ne-itali-shperbehet-rrjeti-nderkombetar-i-ise-10-te-arres-i586759
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:21:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	02ad95f42a97e84f4fe6cf0bcee96c066b5b4905fc6dcddd6989dae3b8f16ef6
TEKSTI	b6b37defd5ba1770094af4551fb1bc38ab55ef5ce037b064d7d5435666d65166
PAMJA	64e3ba16530eddd961ad0899693516c5a6bf79462ac19e8b842f870abd15b4a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	449f8628dfaa5f4d0a9f5cd058b839ae9f604b6025f0ea015c7f72cb4ace1db5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/449f8628dfaa5f4d0a9f5cd058b839ae9f604b6025f0ea015c7f72cb4ace1db5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Kontakti me Iranin, Trump: SHBA-ja ka mbrojtur vendet e Gjirit! Shkaterrohet organizata shqiptare qe frymëzoj serialin "Marbella": Kapen 2.7 ton kokaine dhe arreshtohet fundit](#)

Tronditëse në Itali/ Shpërbëhet rrjeti ndërkombëtar i pedofilisë, 10 të arrestuar në Romë



17 Shtator 2026, 21:30 Bota TEMA



Prokuroria e Romës ka ndërmarrë një operacion me përmasa ndërkombëtare duke arrestuar 10 persona, mes të cilëve katër italianë dhe një zviceran, të akuzuar për krijimin e një organizate kriminale të specializuar në shpërndarjen e materialit pedopornografik. Viktimat e këtij rrjeti të tmerrshëm janë fëmijë të moshave nga 4 deri në 10 vjeç.

Hetimet e drejtuara nga Prokurori Francesco Lo Voi dhe prokurori Geraci zbuluan se grupi, i krijuar në vitin 2020, funksiononte me strukturë piramidale. Të dyshuarit, të moshave mjaft të reja (nga 22 deri në 28 vjeç), e nisën aktivitetin e tyre përmes grupeve të lojërave online, ku u njohën përpara se të ktheheshin në predatorë seksualë.

Krerët e rrjetit përdornin kanale dhe "Bot" në platformën Telegram për të fshehur identitetin e tyre dhe për të depersonalizuar kontaktin me klientët. Peshë kryesore mbanin pesë administratorë, të cilët njiheshin nga përdoruesit vetëm me pseudonimin "Mbreti" dhe mbledheshin në një dhomë virtuale të sigurt të quajtur "Dhoma e Mbretërve".

Për të pasur akses në foto dhe video, deri në 1,000 abonentë nga e gjithë bota paguanin tarifa mujore nga 3 deri në 9 euro, ose detyroheshin të ngarkonin vetë materiale të reja pedopornografike. Të ardhurat e mbledhura ishin mjaft të mëdha dhe shërbenin për të financuar dhe zgjeruar aktivitetin e organizatës.

Zbulimi dhe shpërbërja e këtij rrjeti u bë i mundur falë një agjenti të infiltruar policor. Agjenti arriti të depërtojë deri në nivelet më të larta të drejtimit, duke administruar financat e grupit dhe duke mbledhur prova vendimtare për të identifikuar anëtarët dhe për të arritur deri tek arrestimet.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin "Marbella": Kapen 2.7 ton kokainë dhe arrestohen 15 persona në Spanjë](#)

21:10 Bota

[Rusët godasin anijen turke pranë kufirit me Rumaninë, raportohet për viktime](#)

19:50 Bota / 1 koment

[Eurodeputetja greke e ekstremit të djathtë sulmon ashpër Von der Leyen: Nuk ka raciste më të madhe kundër evropianëve se ju](#)

18:10 Bota / 10 komente

[Jordania dhe Franca nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në mbrojtje](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.